



Kemi diçka për të thënë

Ky është vizioni i Akademisë Policore të Republikës së Maqedonisë, anëtare e Universitetit "Shën Klimenti i Ohrit", Manastir. Për ne, mësimdhënësit, quadrit shkencor dhe arsimor, personelit ndihmës dhe udhëheqësisë, ky vizion është pasqyra e ardhmërisë sonë. Ne planifikojmë këtë vizion ta realizojmë gjatë viteve të ardhshme.

Doc. Dr. Slagjana Taseva
Drejtor

Ligji për Akademinë Policore hyri në fuqi më 1 korrik 2003. Ky Ligj Akademisë Policore ia jep rolin udhëheqës në gjurmimin dhe arsimimin në fushën e punës policore dhe fushat tjera të sigurimit. Dëshirojmë rolin tonë arsimor ta forcojmë përmes sigurimit të edukimit themelor dhe të vazhdueshëm, me kualitet të pranuar në nivel nacional dhe ndërkombëtar, si dhe përmes vlerësimit, përhapjes, produksionit dhe aplikimit të diturisë shkencore në sferën e punës policore dhe fushat tjera të sigurisë.

Duam të bëhemi qendër e kualitetit në këtë pjesë të botës dhe t'u takojmë pesë Akademiave Policore më të mira në Evropë. Mendojmë se jemi përgjegjës për modernizimin në fushën e hetimeve dhe edukimit. Edukimi i jonë policor do të pranohet në nivel nacional dhe ndërkombëtar. Kjo do të thotë se do t'i plotësojmë standardet nacionale dhe ndërkombëtare për kualitet. Diplomati tona do të pranohen gjithkund në Evropë dhe do ta lehtësojnë studimin jashtë vendit. Me atë që do të bëhet qendër e kualitetit, policisë maqedonase dhe organeve tjera të sigurimit do t'i mundësohet lidhshmëri e ngushtë me ekspertizë të jashtëzakonshme. Kështu do të mund t'i shërbejmë në mënyrën më të mirë policisë dhe organeve tjera nga fusha e sigurimit në shtetin tonë.

Edukimi policor do t'i shërbejë policisë operative e cila është përgjegjëse për kryerjen e punës policore në vendin tonë. Do të përqëndrohemi në lehtësimin për arritjen e kompetencave për kryerjen në mënyrë përkatëse të aktiviteteve qenësore në punët dhe funksioneve. Kompetenca është aftësi për ballafaqim në mënyrë përkatëse me aktivitetet qenësore në punë dhe funksionet. Kompetencat bazohen në dituri, aftësi, përvoja, qëndrime dhe sjellje personale. Aktiviteti qenësor është një tërësi konsekuente e detyrave dhe problemeve kryesore me të cilat profesionisti ballafaqohet rregullisht, si dhe karakteristika për një profesion në një nivel të caktuar. Profili i punës përbëhet prej një numri të kufizuar të aktiviteteve qenësore.



Nëpunësit policor të cilët nuk i zotërojnë aktivitetet qenësore në punën e tyre nuk mund të kualifikohen si kompetent. Orientimi i ynë drejt kompetencave dhe aktiviteteve qenësore tregon se ne përqëndrohemi në aftësitë e njerëzve, tash dhe në të ardhmen. Nëpunësit policor duhet të jenë kompetent sot, nesër, muajin e ardhshëm dhe deri në fund të karrierës së tyre profesionale. Prandaj, mbetja kompetent nxit të mësuarit gjatë tërë jetës. Ne do të krijojmë dhe do t'i përkrahim mjediset përkatëse për të mësuar për nëpunësit policor, ashtu që ata do të mund të mësojnë vazhdimisht.

Zhvillimi i kompetencave nxit të mësuarin. Mësimi është çdo ndryshim në dituritë, aftësitë, përvojat ose qëndrimet. Nga pika organizuese, mësimi efektiv ka si rezultat ndryshime në sjelljen, të cilat mund të vërehen dhe të maten. Shumica e njerëzve mendojnë se mësimi zhvillohet vetëm nëpër shkolla. Shkolla është vend i mirë për mësim, kjo është e vërtetë. Sidoqoftë, nëse shikojmë me kujdes, do të vërejmë se nëpunësit e mirë policor bëhen gjithnjë e më kompetent gjatë karrierës së tyre profesionale. Ata për punën e tyre mësojnë në vendin e punës. Vendi i punës bëhet gjithnjë e më shumë një mjedis i shkëlqyeshëm për të mësuar. Mësimi në vendin e punës zhvillohet kur nëpunësit policor punojnë individualisht ose bashkë me të tjerët në teorinë, pritet dhe aktivitetet e tyre personale. Mësimi, gjithashtu, realizohet edhe kur nëpunësit policor e krijojnë ose zbulojnë diturinë ekzistuese, e cila është përkatëse për zgjidhjen e problemeve të tyre profesionale. Bashkë me policinë operative, vendi i punës mund të shfrytëzohet në mënyrë intensive si mjedis për të mësuar.

Nëpunësit policor kanë funksion të rëndësishëm shoqëror dhe prej atyre pritet të mbesin kompetentë gjatë tërë karrierës së tyre profesionale. Marrja e përgjegjësisë është një prej cilësive kryesore të profesionit policor. Kjo çon drejt përgjegjësisë kryesore lidhur me punën dhe mësimin e tyre. Prandaj nëpunësve policor duhet t'u jepet përgjegjësia për mësimin e tyre personal. Ky proces fillon prej çastit kur ata do të hyjnë për herë të parë në Akademi dhe do të vazhdojnë gjithmonë kur do ta vizitojnë Akademinë pas mbarimit të shkollimit të tyre. Mësimdhënësit dhe instrukturët në shkollat do ta lehtësojnë dhe ngrisin të mësuarin e nxënësve të tyre. Edhe njërit edhe të tjerit janë ekspertë me kualifikime të lartë dhe paraqesin shembuj të rëndësishëm.

Nëpunësit policor duhet të jenë në hap me ndryshimet e shpejta në shoqëri. Edukimi ka për qëllim t'u përshtaten atyre ndryshimeve me parimet e të mësuarit gjatë tërë jetës. Përqëndrimi në mësimin gjatë tërë jetës do t'u mundësojë studentëve të bëhen profesionistë bashkëkohor. Akademia Policore i përgatit studentët të punojnë në shoqëri e cila ndryshohet në mënyrë të rëndësishme në fusha të ndryshme dhe në çdo fushë ndryshimet janë gjithnjë e më të thella. Për të ruajtur hapin me këto ndryshime, nevoja për arritjen e kompetencave të reja dhe më të gjëra paraqet parakusht. Prandaj, aftësia dhe dëshira për të mësuar është më e rëndësishme për nëpunësit policor ku dallohet konteksti i gjerë i të mësuarit: në shtëpi, në vendin e punës, në bashkësinë dhe në shkollat. Me fjalë



tjera, mësimi zhvillohet gjatë tërë jetës dhe ata të cilët mësojnë gjatë tërë jetës janë ata të cilët angazhohen me vetëdije edhe në mësimin formal edhe në atë joformal. Edukimi në Akademinë Policore do t'i bashkojë elementet të cilat do t'u mundësojnë studentëve të mësojnë gjatë tërë jetës. Studentët do të udhëzohen në mënyrë eksplicite të mësojnë sipas programit ku përgjegjësia për të mësuar drejtohet shkallë-shkallë drejt studentit. Për Akademinë Policore, përfshirja në të mësuarit gjatë tërë jetës do të thotë se duhet punuar bashkë me forcat policore për të siguruar përvoja për mësimin të cilat vërtetë do t'i paraqesin nevojat e punës policore në Republikën e Maqedonisë. Akademia Policore dhe forcat policore duhet të bashkëpunojnë me qëllim të krijimit, sigurimit dhe ruajtjes së përvojës për mësim për studentët të cilët do ta kombinojnë mësimin akademik dhe mësimin e fituar në kontekst të krijimit të udhës për të mësuar e cila është e përshtatshme dhe e vlerësuar nga ana e studentëve dhe mjediseve të tyre profesionale.

Në praktikën e përditshme policore njëra prej kompetencave kyçe të nëpunësve policor është puna e përbashkët me kolegë të ndryshëm gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Ekziston një theks i shtuar të punës ekipore në mjedisin punues ku punëtorët duhet të jenë të aftë të mendojnë në mënyrë kreative, t'i zgjidhin problemet dhe vendmet t'i marrin si një ekip. Përmes futjes eksplicite të kompetencave për bashkëpunim në programin e Akademisë Policore, studentët do të përgatiten më mirë për detyrat e tyre në vendet e punës së ardhshme. Gjithashtu, këmbimi aktiv i ideve, koncepteve dhe parimeve në grupe të vogla të studentëve do ta rrit interesin mes atyre. Ekipet të cilat bashkëpunojnë arrin nivel më të lartë të të mednuarit dhe i ruajnë informatat më gjatë nga ata të cilët punojnë si individë.

Mësimi i përbashkët u mundëson studentëve të kyçen në diskutime, të jenë përgjegjës për mësimin personal, domethënë të bëhen mendimtarë kritik. Mësimdhënësit duhet ta mbikëqyrin procesin në të gjitha ekipet dhe ta kontrollojnë më me kujdes procesin kur bëhet fjalë për zotërim me diturinë kryesore. Kur studentët do ta njohin materialin në mënyrë të mjaftueshme, mësimdhënësit do të mund të kthehen disa hapa mbrapa.

Studentët tonë janë përgjegjës për mësimin e tyre. Pasi që mësimi në Akademinë Policore dominohej dhe kontrollohej nga ana e mësimdhënësve, nxënësit rrallë merrnin vendime për mësimin e tyre. Edhe pse në këtë çast filozofia e jonë për edukimin policor është drejtuar kah prodhimi i kuadrove të cilët janë policë të përgjegjshëm të cilët janë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë racionale në një demokraci, praktikat arsimore në Akademinë Policore kanë tendencë ta nxisin varësinë, pasivitetin nga ana e atij i cili mëson dhe qëndrim i cili mund të përshkruhet si: "tregomëni ç'të bëj dhe si të mendoj".

Dhënia e përgjegjësisë studentëve për mësimin e tyre do t'u mundësojë atyre të jenë nxënës më të angazhuar dhe të krijojnë mjedise më dinamike dhe më të pasura për të mësuar. Studentët e atillë janë të përgjegjshëm dhe të vetëkahëzuar. Ata i definojnë



qëllimet e të mësuarit dhe problemet të cilat janë të rëndësishme për ata dhe të cilat japin një pasqyrë globale në çfarë mënyrë aktivitetet specifike janë të përshtatshme me ato qëllime. Nxënësit e vlerësojnë procesin e tyre të të mësuarit dhe e përshtasin atë kur ka nevojë. Ata i dinë anët e mira dhe dobësitë e tyre dhe dinë si të ballafaqohen me të njëjtat në mënyrë produktive dhe konstruktive. Nxënësit e angazhuar janë gjithashtu të aftë t'i formësojnë dhe të udhëheqin me ndryshimet dhe, gjithashtu, janë të aftë t'i zgjidhin problemet e reja. Në mjediset e angazhuara për të mësuar mësime të duhura duhet ta lehtësojnë procesin dhe t'i aktivizojnë studentët ashtu që studentët të jenë të aftë të marrin përgjegjësi. Përveç mësimit si të bëhen nëpunës kompetentë policor, studentët duhet të mësohen edhe si të mësojnë. Në këtë proces të të mësuarit-si-të-mësohet, studentëve do t'u jepen përgjegjësi më të mëdha për të mësuarin e tyre personal.

Studentët mësojnë në mjedise aktive për të mësuar në të cilat zgjidhin probleme, u përgjigjen pyetjeve, formulojnë pyetje të tyre, diskutojnë, shpjegojnë, debatojnë gjatë orës, çka është në kundërshtim me metodat më konvencionale ku mësime të mësuara është në qendër të vëmendjes.

Mësime të shpesh e gjejnë veten në sprovë t'ua japin përgjigjet studentëve. Derisa kjo duket si strategji përkatëse në disa rrethana, ajo gjithashtu do të mund ta rrënojë zhvillimin e të kuptuarit të studentit. Për t'i zhvilluar mjediset në të cilat studentët zhvillojnë të kuptuarin më të thellë, aktivitetet e tyre duhet, e para, të drejtohen kah gjykimi dhe vlerësimi i dëshmi. Kjo do t'u mundësojë studentëve të zhvillojnë aftësi për formulim dhe zgjidhje të problemeve. E dyta, kur do të ballafaqohen me vështirësi, studentët duhet nxitur të bëjnë supozime për problemin dhe si t'i qasen atij më mirë. Prej studentëve do të kërkohet të punojnë së bashku, mes vete dhe me mësime të duhura. Në këtë bashkëpunim theksi do të vihet në të menduarit të studentëve, parashtrimin e pyetjeve, marrëveshjeve dhe strategjive për zgjidhjen e problemeve. Me qëllim të krijimit të qasjes pedagogjike për angazhim aktiv në mësim, mësime të duhura do të duhet të parashtrorin probleme sfiduese, të nxisin diskutime të përbashkëta mes studentëve, studentëve t'u japin kohë të mjaftueshme për t'u ballafaquar me problemin dhe për të punuar në aspekte të ndryshme të problemit.

Para mësime të duhura tonë qëndron sfida të parashtrorin probleme dhe ta theksojnë thelbin e lëndës përkatëse. Me qëllim që të ligjerojnë për angazhimin aktiv në mësim, ata nuk duhet të jenë vetëm nëpunës kompetent policor, por duhet të kenë edhe dituri të caktuar pedagogjike.

Mësime të duhura në Akademinë Policore dhe instruktorët në vendet e punës janë lehtësues në procesin e të mësuarit të studentëve. Ata u lejojnë studentëve të fitojnë kompetencat e domosdoshme në mënyrë në të cilën studentët do të jenë përgjegjës për të mësuarit të tyre, individualisht dhe si pjesë e ekipit.



Mësimi nuk zhvillohet vetëm në Akademinë Policore, por ai është gjithashtu i përfshirë edhe në punë - vendin e ardhshëm të punës. Akademia Policore studentëve u siguron mjedis për të mësuar, ku mësimdhënësit ofrojnë mundësi për arritjen e kompetencave të para në të mësuarin e punës. Studentët tonë do të fitojnë kompetenca të thelluara dhe do t'i fitojnë përvojat e para të cilat do t'i përgatisin ata për rolin e profesionistëve kompetent. Mësimdhënësit në Akademinë Policore dhe instruktorët në vendet e punës do ta përmbushin rolin e tyre në pajtim me qëllimet e nevojshme për të mësuar, të përshkuara më lart.

Mësimdhënësit e përkrahin procesin e të mësuarit të studentëve përmes shpjegimeve, demonstrimeve dhe sigurimit të stërvitjeve për aftësitë të cilat duhet të shfrytëzohen gjatë procedurës. Duke marrë parasysh kryerjen e kësaj detyre, mësimdhënësi jep informata specifike dhe parashtron pyetje të drejtpërdrejta. Ai u ndihmon studentëve në mirëmbajtjen e procesit të mësimit dhe i udhëzon drejt drejtimit të vërtetë kur është e nevojshme të intervenohet përmes dhënies së vlerësimeve dhe dhënies së përgjigjes kthyesë. Me fjalë tjera, mësimdhënësi krijon mjedis dhe parakusht për mësim. Në fund, mësimdhënësi mund gjithashtu të krijojë mjedis për të mësuar, aktivitete të lidhura me mësimin, mjete arsimore, metoda pedagogjike dhe materiale të cilat kanë për qëllim t'ua lehtësojnë mësimin studentëve.

Për instruktorët në vendet e punës është me rëndësi që ata të jenë profesionist kompetent për aktivitetet qenësore përmes së cilave studentët fitojnë kompetenca. Më tutje, me qëllim që studentëve t'u mundësohet të mësojnë në mënyrë efektive, instruktorët duhet të zotërojnë kompetenca përkatëse pedagogjike.

Akademia e jonë gjendet në procesin e zhvillimit. Si edhe shumë institucione tjera në shtetin tonë, edhe ne marrim ndihmë plotësuese prej bashkësisë ndërkombëtare dhe bashkëpunojmë me gjithnjë e më shumë partnerë. Edhe ndihma e cila merret për këtë vizion do të koordinohet nga ana e bashkësisë ndërkombëtare. Koordinimi do të mundësojë përkrahja e ofruar ta kënaq modelin organizues dhe edukues të miratuar nga ana e Akademisë.